



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. Akti

Nr. 198 Vendimi
Tiranë, më 8.10.2019

V E N D I M

Trupi gjyqes i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Pamela Qirko	Anëtare
Etleda Çiftja	Relatore

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në datën 8.10.2019, në mjediset e punës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT: **Znj. Ema Gashi**, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

BAZA LIGJORE: Neni “G” i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtareve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES:

1. Me anë të shkresës nr. *** prot., datë 4.9.2019, i është njoftuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendimi nr. 106, datë 5.7.2019, “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, të gjyqtares Ema Gashi, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit”.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 64 dhe 65, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në kërkesën e regjistruar me aktin nr. *** prot., datë 3.5.2019, për dorëheqje të gjyqtares Ema Gashi, ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit të gjyqtares Ema Gashi, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtares. Efektet ligjore të këtij vendimi fillojnë në datën 30.6.2019.

3. Referuar parashikimit kushtetues të nenit 84/3, datës së miratimit të ligjit nga Parlamenti dhe datës të botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare, si dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin dhe rrëzimin e kërkesës për shfuqizim, ligji hyri në fuqi në datën 8.10.2016.

4. Në datën 25 .10.16, ligji u pezullua nga Gjykata Kushtetuese. Për këtë arsye afati i zbatimit të ligjit eci për 17 ditë deri në 19 janar 2017. Në datën 18.1.2017, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e ligjit. Ky vendim u botua në Fletoren Zyrtare në datën 19.1.2017. Si rezultat afati 30 ditor në dispozicion të subjekteve të rivlerësimit për dorëzimin ka përfunduar në datën 31 janar 2017.

5. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për znj. Ema Gashi, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka filluar menjëherë me:

- a. plotësimin dhe dërgimin e deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 , të ligjit nr. 84/2016, në ILDKPKI, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
- b. plotësimin dhe dërgimin e deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016, në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
- c. plotësimin dhe dërgimin e formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 41.

6. Me vendimin nr. 16, datë 26.2.2019, mbledhja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ka vendosur ngritjen e trupit gjykues që do të vendosë për dorëheqjet e subjekteve të rivlerësimit, për një periudhë 1-vjeçare.

7. Trupi gjykues, i shortuar për këtë qëllim, përbërët nga:

Pamela Qirko	Komisionere
Lulzim Hamitaj	Komisioner
Etleda Çiftja	Relatore

II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

1. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr.

84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”

2. Pika 3, e nenit 179/b të Kushtetutës parashikon se procesit të rivlerësimit i nënshtrohen të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë.

3. Trupi gjykues konstaton se, znj. Ema Gashi, ka qenë me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Durrës, duke qenë kështu në rrethin e subjekteve të rivlerësimit që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*.

4. Me vendimin nr. 106, datë 5.7.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit të gjyqtarës Ema Gashi, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit.

5. Pika 1, e nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, përcakton: “*Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: a) jep dorëheqjen...*”.

6. Neni 65, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, si më poshtë vijon: “1. *Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinim me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.*”

7. Neni “G”, i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: “1. *Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare*”.

8. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta dhe ligji, për dorëheqje nga statusi i magjistratit.

9. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit “G”, të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin “G”, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 57, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprejen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Ema Gashi.
2. Ndalimin e emërimit të znj. Ema Gashi si gjyqtare ose prokurore e çdo niveli, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektore e Lartë e Drejtësisë ose Prokurore e Përgjithshme, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet, subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Ky vendim u shpall, në datën 8.10.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Pamela QIRKO
Anëtare

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Olsida GOXHAI
Sekretare gjyqësore